Врз основа на член 427 став (1) и член 438 алинеја 9, а во врска со член 291 став (6) од Законот за финансиски инструменти (Службен весник на Република Северна Македонија бр. 66/2024), Комисијата за хартии од вредност на Република Северна Македонија на седницата оджана на ден 10.09.2025 година донесе

## ПРАВИЛНИК [1]
## за видовите на високоликвидните финансиски инструменти во кои овластен депозитар може да ги вложува своите средства

### Член 1

Со овој Правилник поблиску се уредува:

- видовите на финансики инструменти кои можат да бидат високоликвидни во кои овластен депозитар може да ги вложува своите средства и
- времетраењето на продажбата на високоликвидните финансиските инструменти со цел правична распределба на паричните средства и финансиските инструменти при нивното вложување од страна на овластениот депозитар.

Në bazë të nenit 427, paragrafi (1) dhe nenit 438, nënparagrafi 9, dhe në lidhje me nenin 291, paragrafi (6) të Ligjit të Instrumenteve Financiare (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 66/2024), Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më datë 10.9.2025 miratoi

## RREGULLORE [1]
## për llojet e instrumenteve financiare me likuiditet të lartë në të cilat depozitari i autorizuar mund t’i investojë asetet e veta

### Neni 1

Me këtë Rregullore së afërmi rregullohet:

- llojet e instrumenteve financiare të cilat mund të jenë me likuiditet të lartë në të cilat depozitari i autorizuar mund t’i investojë asetet e veta dhe
- kohëzgjatja e shitjes së instrumenteve financiare me likuiditet të lartë me qëllim të shpërndarjes së drejtë të aseteve monetare dhe instrumenteve financiare gjatë investimit të tyre nga ana e depozitarit të autorizuar.

---

[1] Со овој Правилник се врши усогласување со:

- Делегираната уредба 2017/392 за дополна на директивата 909/2014 во поглед на регулаторните технички стандарди поврзани со одобрението за работа и надзорните и оперативните барања за депозитарите за хартии од вредност

Me këtë Rregullore kryhet harmonizim me:

- Dekretin e deleguar 2017/392 për plotësimin e direktivës 909/2014 në aspektin e standardeve teknike rregullatore që lidhen me miratimin për punë dhe kërkesat mbikëqyrëse dhe operative për depozitarët e letrave me vlerë

**Член 2**

(1) Овластениот депозитар може своите средства да ги вложува единствено во парични депозити и високоликвидни финансики инструменти со минимален кредитен и пазарен ризик.

(2) Депозитарот е должен да обезбеди правична распространетост на паричните средства и високоликвидните финансиските инструменти при нивното вложување во банки (кредитни институции) со соодветно одобрение за работа или во депозитари кои имаат соодветно одобрение за работа.

**Член 3**

(1) Со цел исполнување на условите од член 2 став (1) на овој Правилник депозитарот може да вложува во финансиски инструменти кои се високоликвидни со минимален кредитен и пазарен ризик кои се должнички инструменти и кои ги исполнуваат следните критериуми:

1. ги издала или за нив гарантира
   - држава;
   - централна банка;
   - европски инструмент за финансика стабилност или европски механизам за стабилност.
2. овластениот депозитар може да докаже дека финансиките инструменти имаат низок кредитен и пазарен ризик откако ќе направи интерна проценка;
3. се изразени во следните валути:

**Neni 2**

(1) Depozitari i autorizuar mund t'i investojë asetet e veta vetëm në depozita monetare dhe instrumente financiare me likuiditet të lartë me një rrezik minimal kreditues dhe të tregut.

(2) Depozitari është i obliguar që të sigurojë shpërndarjen e drejtë të aseteve monetare dhe instrumenteve financiare me likuiditet të lartë gjatë investimit të tyre në banka (institucione kreditimi) me miratim përkatës për punë ose në depozitarë të cilët kanë miratim përkatës për punë.

**Neni 3**

(1) Me qëllim të përmbushjes së kushteve nga neni 2, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje, depozitari mund të investojë në instrumente financiare të cilat janë me likuiditet të lartë me një rrezik minimal kreditues dhe të tregut, të cilat janë instrumente borxhi dhe të cilat i përmbushin kriteret në vijim:

1. i ka emetuar ose për ato garanton:
   - shteti;
   - banka qendrore;
   - instrumenti europian për stabilitet financiar ose mekanizëm europian për stabilitet.
2. depozitari i autorizuar mund të dëshmojë se instrumentet financiare kanë rrezik të ulët kreditues dhe të tregut pasi që do të bëjë një vlerësim të brendshëm;
3. janë të shprehura në valutat në vijim:

- во валута во која се врши порамнување на трансакциите во системот за порамнување на хартии од вредност со кој управува овластениот депозитар;
- во било која друга валута со чии ризици овластениот депозитар може да управува.

4. преносливи се, без регулаторни ограничувања и без побарувања од трета страна заради кои не е можна ликвидација;

5. за нив постои активен пазар за директна продажба;

6. постојат редовно и јавно достапни сигурни информации за цените на тие инструменти.

(2) За потребите на точка 2 од став (1) на овој член, при проценката, депозитарот треба да применува дефинирана и објективна методологија која не се заснова исклучиво на надворешни мислења и со која се земаат предвид ризиците кои настануваат по приемот на тргување на издавачот во одредена земја.

(3) По исклучок на став (1) на овој член деривативните финансики инструменти се високо ликвидни финансиски инструменти со минимален кредитен и пазарен ризик ако се задоволени следните услови:

1. склучени се за потребите на заштита од валутен ризик кој настанува заради порамнување во повеќе валути во системот за порамнување на хартии од вредност со кои управува депозитарот или каматниот ризик кој може да влијае на имотот на

- në valutë në të cilën kryhet shlyerja e transaksioneve në sistemin për shlyerje të letrave me vlerë me të cilin administron depozitari i autorizuar;
- në cilëndo valutë tjetër me rreziqet e së cilës depozitari i autorizuar mund të administrojë.

4. janë të transferueshme, pa kufizime rregullatore dhe pa pretendime nga një palë e tretë për shkak të së cilave nuk është i mundur likuidim;

5. për ato ekziston treg aktiv për shitje të drejtpërdrejt;

6. ekzistojnë informacione të sigurta të cilat janë rregullisht dhe publikisht të disponueshme për çmimet e instrumenteve në fjalë.

(2) Për nevojat e pikës 2 nga paragrafi (1) i këtij neni, gjatë vlerësimit, depozitari duhet të zbatojë metodologji të përkufizuar dhe objektive e cila nuk bazohet ekskluzivisht në mendime të jashtme dhe me të cilën merren parasysh rreziqet të cilat krijohen pas pranimit në tregtim të emetuesit në një vend të caktuar.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, instrumentet financiare derivative janë instrumente financiare me likuiditet të lartë me një rrezik minimal kreditues dhe të tregut nëse janë të përmbushura kushtet vijuese:

1. janë të përmbyllura për nevojat e mbrojtjes nga një rrezik valutor i cili krijohet për shkak të shlyerjes në një numër valutash në sistemin për shlyerje të letrave me vlerë me të cilat administron depozitari ose rreziku kamator i cili mund të ndikojë në pronën e depozitarit, edhe në të dy rastet

депозитарот и во двата случаи се сметаат за договори за заштита од ризик во согласност со меѓународните сметководствени стандарди;

2. редовно се објавуваат сигурни податоци за цените за тие деривативни финансики инструменти;

3. тие се склучуваат на одредено време кое е нужно за валутен или каматен ризик на кој депозитарот е изложен.

**Прифатлива временска рамка за пристап до имотот**

**Член 4**

(1) Депозитарот мора да има непосреден и неусловен пристап до паричните депозити.

(2) Депозитарот мора да има пристап до финансиските инструменти истиот работен ден кога е донесена одлука за ликвидација на финансикиот инструмент.

(3) За цели на исполнување на ставовите (1) и (2) депозитарот треба да воспостави правила со кои ќе обезбеди дека депозитарот може да пристапи до паричните депозити и до финансиските инструменти во роковите кои се во нив утврдени.

(4) Депозитарот е должен да ја извести Комисијата за секоја промена на тие правила и истиот е должен да ги усвои откако ќе добие потврда за тие промени.

konsiderohen si kontrata për mbrojtje nga rreziku në pajtim me standardet ndërkombëtare kontable;

2. rregullisht publikohen të dhëna të sigurta për çmimet për ato instrumente financiare derivative;

3. ato përmbyllen në një kohë të caktuar e cila është e domosdoshme për rrezik valutor ose kamator në të cilin është i ekspozuar depozitari.

**Korniza e pranueshme kohore për qasje në pronën**

**Neni 4**

(1) Depozitari duhet të ketë qasje të drejtpërdrejt dhe të pakushtëzuar në depozitat monetare.

(2) Depozitari duhet të ketë qasje në instrumentet financiare të njëjtën ditë të punës kur është miratuar vendimi për likuidimin e instrumentit financiar.

(3) Për qëllime të përmbushjes së paragrafëve (1) dhe (2), depozitari duhet të vendos rregulla me të cilat do të sigurojë se depozitari mund të ketë qasje në depozitat monetare dhe në instrumentet financiare në afatet të cilat janë të përcaktuara në të njëjtat.

(4) Depozitari është i obliguar që të njoftojë Komisionin për çdo ndryshim të atyre rregullave dhe i njëjti është i obliguar që t'i miratojë pasi që do të merr konfirmim për ndryshimet në fjalë.

**Ограничување за концентрација на поединечни субјекти**

**Член 5**

(1) Депозитарот е должен да ги чува своите средства во диверзифицирани кредитни институции или депозитари кои имаат одобрение за работа од друг надлежен орган со цел да остане во рамки на прифатливите ограничувања за концентрација .

(2) Прифатливите ограничувања за концентрација се утврдуваат врз основа на :

1. географската распределба на субјектите кај кои депозитарот ги чува своите средства;
2. зависниот однос кој, субјектот кој ги чува средствата или субјект од неговата група, можат да го имаат со депозитарот;
3. нивото на кредитниот ризик на субјектот кој ги чува средствата на депозитарот.

**Член 6**

Овој Правилник влегува во сила 8 дена од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија, а ќе се применува со денот на почеток на примена на Законот за финансиски инструменти".

**Kufizimi për koncentrim të subjekteve individuale**

**Neni 5**

(1) Depozitari është i obliguar që t'i ruajë asetet e veta në institucione të diversifikuara kredituese ose depozitarë të cilët kanë miratim për punë nga një organ tjetër kompetent me qëllim që të mbet në suaza të kufizimeve të pranueshme për koncentrim.

(2) Kufizimet e pranueshme për koncentrim përcaktohen në bazë të:

1. shpërndarjes gjeografike të subjekteve te të cilët depozitari i ruan asetet e veta;
2. raportit të varësisë të cilin, subjekti i cili i ruan asetet ose një subjekt nga grupi i tij, mund ta kenë me depozitarin;
3. nivelit të rrezikut kreditues të subjektit i cili i ruan asetet e depozitarit.

**Neni 6**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe do të zbatohet me ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit të Instrumenteve Financiare.

**Број/Numër 01-505/4**
**Скопје/Shkup, 10.09.2025 година**

**Комисија за хартии од вредност на Република Северна Македонија**
**Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut**
**Претседател/Kryetarja**
**Mr. Bujare Abazi**

KHV na RSM
Digitally signed by KHV na RSM
Date: 2025.09.10 11:38:27 +02'00'

Bujare Abazi
Digitally signed by Bujare Abazi
Date: 2025.09.10 11:37:27 +02'00'